



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"

UNIVERSITETI I GJILANIT UNIVERSITY OF GJILAN			
Pranuar Data: 18.12.2017			
Kategoria/orig		Numer	Vlera
		01	2128

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA NEKOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR NDHIMË JURIDIKE FALAS
AGENCIJA ZA BESPLATNI PRAVNI POMOC
AGENCY FOR FREE LEGAL AID

Nr./Br.No. 201-02 / Klasifikim 03
Data/Date/Date: 11.12.2017
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA



NDIHMA JURIDIKE | PRAVNA POMOC
LEGAL AID

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të

Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan, përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Z. Bajram Kosumi, Rektor, tani e tutje si UKZ,

dhe

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas, përfaqësuar nga z. Ramadan Gashi, Drejtor Ekzekutiv, tani e tutje si ANJF,

Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

1. Qëllimi i Marrëveshjes:

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është angazhimi për punë praktike për studentët e UKZ-së në ANJF.

Kohëzgjatja e ushtrimit të praktikës për studentët e UKZ-së do të jetë një (3) muaj kalendarik, me mundësi vazhdimi sipas nevojës së ANJF-së.

Angazhimi do të jetë dyzet (40) orë në javë (përfshirë ligjëratave, provimeve dhe obligimeve të tjera që i kanë studentët në fakultet).

Studentët pas përfundimit të praktikës profesionale në ANJF do të pajisen me Letër Konfirmim / Certifikatë për kryerjen e punës praktike.

2. Kriteret për angazhimin e praktikantëve në ANJF

Përzgjedhja e studentëve për punë praktike në ANJF do të bëhet nga ana e UKZ-së, sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht në bashkëpunim me ANJF.

Minimumi i kriterëve të kërkuara nga ANJF-ja, janë si në vijim:

- I. Praktikantët duhet të jenë studentë të UKZ-së kryesisht të drejtimit: Fakulteti Juridik, por me raste edhe në drejtime tjera, varësisht nga nevojat dhe interesi i ANJF-së;
- II. Praktikantët, duhet të jenë minimum në vitin e katërt (IV-të) të studimeve në UKZ, në përjashtim nga fakultetet e tjera mund të jenë në vitin e tretë (III-të) studimeve;
- III. Praktikantët, gjatë kryerjes së punës praktike në ANJF, duhet të tregojnë interesim, gatishmëri, përkushtim dhe seriozitet në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi gjegjëse si dhe respektimin e Kodit Etik dhe Orarit të punës;
- IV. Praktikantët duhet të respektojnë rregullat e konfidencialitetit si: ndalimi i publikimeve të pa autorizuara ose forma të tjera të përhapjes së informacioneve për rolin ose punën e ANJF-së, komunikimi me media ose palët tjera për çfarëdo informacioni apo autorizim paraprak të ANJF-së. Rregullat e konfidencialitetit vlejnë edhe pas përfundimit të Marrëveshjes me ANJF-në.

3. Dokumentet e nevojshme

Praktikanti, në ditën e parë të fillimit të punës praktike në ANJF, duhet të sjellë me veti dokumentet si më poshtë:

- ID e studentit (kopje);
- Letënjoftimi (kopje);
- Dokument që verifikon vitin akademik të studimeve në UKZ.

4. Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë për ndryshimet dhe plotësimet e saj si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve.

Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si në vijim:

- Ndryshimet ose plotësimet e Marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre;
- Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë organizim të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

5. Kohëzgjatja dhe efektet juridike

Kjo Marrëveshje lidhet me kohë të caktuar prej gjashtëdhjetë muajve (60) duke filluar nga data 11/12/2017 deri me datë 10/12/2022, me mundësi të zgjatjes së afatit.

Përfundimi i kësaj Marrëveshje mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet të dyja palëve.

Kjo Marrëveshje mund të përfundoj njëanshëm nga njëra palë me paralajmërim prej së paku tre (3) muaj.

Marrëveshjet verbale për çështje të caktuara, gjithashtu nuk gjejnë mbështetje në këtë Marrëveshje dhe ato nuk do të merren parasysh.

6. Standardet

Të dyja palët janë të obliguara të përmbushin këtë Marrëveshje me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etike dhe kompetencë.

7. Gjuha e kontratës

Kjo Marrëveshje do të përpilohet në gjuhën Shqipe.

8. Mospajtimet

Të gjitha mospajtimet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.


9. Ligji i aplikueshëm

Palët respektojnë dhe zbatojnë ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, rregullat dhe kërkesat tjera të aplikueshme të autoriteteve përkatëse shtetërore.

10. Hyrja në fuqi

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, për secilën palë nga një.

Për UKZ:		Për ANJF:	
Emri:	Z. Bajram Kosumi	Emri:	Z. Ramadan Gashi
Pozitat:	Rektor, UKZ	Pozita:	Drejtor Ekzekutiv, ANJF
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data/ Vendi:	11 Dhjetor 2017, Prishtinë	Data/ Vendi:	11 Dhjetor 2017, Prishtinë
Vula:		Vula:	